



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-110-5278

Më datë 06.02.2018

Duke u bazuar në nenin 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe akteve tjera nënligjore, Kryetari i Komunës në Suharekës, merr këtë:

V E N D I M

1. z. Driton Maliqaj- Drejtorë në Drejtorinë për Administratë dhe z. Milit Elshani Drejtor i QKMF-së emërohen Menaxher të projektit me titull; "Shërbimet e pastrimit –godinat, zyrët, oborri, palestra etj" në Komunën e Suharekës.
2. Detyrat e Menaxherit të projektit, janë të përcaktuara me Ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës e që e rregullojnë këtë çështje.
3. Ky vendim hynë fuqi një ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës në Suharekë dhe e shfuqizon vendimin 01-Nr-020/02-42305 të datës 24.08.2017.

Kryetari i Komunës


Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen;

Zyra e prokurimit

Menaxheri i projektit

Arkiva





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-110-5275

Më datë 06.02.2018

Duke u bazuar në nenin 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publike dhe akteve tjera nënligjore, Kryetari i Komunës në Suharekës, merr këtë:

V E N D I M

1. z. Driton Maliqaj- Drejtorë në Drejtorinë për Administratë, emërohet Menaxher i projektit me titull; "Mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike (TI) dhe ueb faqes" në Komunën e Suharekës.
2. Detyrat e Menaxherit të projektit, janë të përcaktuara me Ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës e që e rregullojnë këtë çështje.
3. Ky vendim hynë fuqi një ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës në Suharekë dhe e shfuqizon vendimin 01-Nr-404-35573 të datës 01.08.2017.

Kryetari i Komunës


Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen:

Zyra e prokurimit

Menaxheri i projektit

Arçiva





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-10-5273

Më datë 06.02.2018

Duke u bazuar në nenin 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publike dhe akteve tjera nënligjore, Kryetari i Komunës në Suharekës, merr këtë:

V E N D I M

1. z. Driton Maliqaj- Drejtorë në Drejtorinë për Administratë, emërohet Menaxher i projektit me titull; "Shërbimet e sigurimit të automjeteve zyrtare në pronësi të QKMF-së, NJZ-së dhe DSH-së" në Komunën e Suharekës.
2. Detyrat e Menaxherit të projektit, janë të përcaktuara me Ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës e që e rregullojnë këtë çështje.
3. Ky vendim hynë fuqi një ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës në Suharekë dhe e shfuqizon vendimin 01-Nr-016/01-38996 të datës 14.08.2017.

Kryetari i Komunës


Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen;

Zyra e prokurimit

Menaxheri i projektit

Arkiya





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr 16-7201

Me date 14.02.2018

Duke u bazuar në nenin 5, Ligjit Nr-03/L-068, për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2008", nenit 20, të Ligjit Nr-04/L-032, për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-17/2011" dhe nenin 4, të udhëzimit administrativ, Nr-08/2014 të datës 25.02.2014 të lëshuar nga MASHT-ja dhe konkursit të shpallur nga Drejtoria e Arsimit, me datën 22.01.2018, me numër, Nr- 05-Nr-30, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e panelit intervistues

1. Formohet paneli intervistues për intervistimin e kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin 05-Nr-30, të datës 22.01.2018, nga Drejtoria e Arsimit për drejtor të shkollave të cekur në konkurs, në këtë përbërje:
 - 1.1 Agim Rraqi -----kryesues
 - 1.2 Sahadet Kuçi -----anëtare
 - 1.3 Anëtari i tretë vjen nga MASHT-i, sipas udhëzimit administrativ, Nr-08/2014 i datës 25.02.2014.
 - 1.4 Anëtar dy përfaqësues të keshillit drejtues në cilësinë e vëzhguesve pa të drejtë vote.
2. Detyrë e këtij paneli intervistues është që të bëjë intervistimin e kandidatëve të cilit kanë konkurruar në këtë konkurs dhe në bazë të pikëve të fituar, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandon Kryetarit të Komunës për zgjedhjen e drejtorit të shkollës sipas konkurs.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Kopje :

DA-ja

Paneli intervistues

Arkiva

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-7202

Me date 14.02.2018

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, nenit 35, lidhur me nenin 17, paragrafi 11, pika 2, të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr-04/L-032, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-17/2011" dhe konkursit të shpallur me datën 25.01.2018, me numër 05-Nr-51, nga Drejtoria e Arsimit, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e panelit intervistues

1. Formohet paneli intervistues për intervistimin e kandidatëve që konkurrojnë në konkursin për plotësimin e vendeve të lira të punës për mesimdhënës për vitin shkollor 2017/2018, sipas konkursit të shpallur me datën 25.01.2018, me numër 05-Nr-51, nga Drejtoria e Arsimit në këtë përbërje:

- 1.1 Agim Rraqi-----kryesues
- 1.2 Sahadete Kuqi-----anëtar
- 1.3 Drejtori i shkollës përkatëse-----anëtar/e
- 1.4 Përfaqësuesi i këshillit drejtues i çdo shkolle në cilinë e vëzhguesit---anëtar/e

2. Detyrë e këtij paneli intervistues është që të bëjë intervistimin e kandidatëve të cilit kanë konkurruar në këtë konkurs, si që është cekur në nenin 1, të këtij vendimi dhe të përzgjedhin kandidatët më të suksesshmin për plotësimin e këtyre vendeve të lira të punës.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Kopje :
DΔ-ja
Paneli intervistues
Arkiva

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-110-5283

Më datë 06.02.2018

Duke u bazuar në nenin 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publike dhe akteve tjera nënligjore, Kryetari i Komunës në Suharekës, merr këtë:

V E N D I M

1. **z. Driton Maliqaj**- Drejtorë në Drejtorinë për Administratë, **z. Xhevat Rexhaj**-Zyrtar në QKMF- dhe **z. Vehbi Krasniqi**-Shef i njësisë së zjarrfikësve **emërohen Menaxher i projektit me titull; "Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare"** në Komunën e Suharekës.
2. Detyrat e Menaxherit të projektit, janë të përcaktuara me Ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës e që e rregullojnë këtë çështje.
3. Ky vendim hynë fuqi një ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës në Suharekë dhe e shfuqizon vendimin 01-Nr-016-22780 të datës 25.05.2017.

Kryetari i Komunës


Bali MCHARREMAJ

Të njoftohen;

Zyra e prokurimit

Menaxheri i projektit

Arkiva





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-216-7/99

Më datë 14.02.2018

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 15, i Ligjit Nr 04/L-174, për Planifikim Hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013" dhe nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016" Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Ekipit Komunal për Planifikim të PZHK-së

1. Me qëllim të ofrimit të vizionit, qëllimit dhe objektivave në procesin e planifikimit të Planit Zhvillimor Komunal, e që duhet të definohen në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, formohet Ekipi Komunal i Planifikimit të PZHK-së në këtë përbërje:
 - 1.1 Sanie Kuqi, Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim,
 - 1.2 Kurtesh Fondaj, koordinator i projektit,
 - 1.3 Nexhmije Loshi-Durmishi, Shefe e Sektorit të Urbanizmi,
 - 1.4 Isuf Hajdari, Drejtorja për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë,
 - 1.5 Shaqir Mala, Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
 - 1.6 Shkelqim Salihu, Drejtorja për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër,
 - 1.7 Driton Maliqaj, Drejtorja për Administratë,
 - 1.8 Mehdi Gollapeni, Drejtorja për Inspektion,
 - 1.9 Agim Bylykbashi, Drejtorja për Ekonomi dhe Financa,
 - 1.10 Xhemajli Aliu, Drejtorja për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,
 - 1.11 Sahadete Lumi Kuqi, Drejtorja për Arsim dhe
 - 1.12 Refki Gollapeni, Drejtorja për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë.
2. Udhëheqëse i Ekipit Komunal për Planifikim të PZHK-së, sipas detyrës zyrtare, emërohet znj. **Sanie Kuqi**.
3. Koordinator i Ekipit Komunal për Planifikim të PZHK-së, për koordinimin e punëve të Ekipit Komunal për Planifikim të PZHK-së dhe firmës konsulentë "INSI" Sh.P.K me seli në Prishtinë, është z. **Kurtesh Fondaj**.
4. Detyra e Ekipit Komunal për Planifikim (EKP) është të punojnë në hartimin e PZHK-së, në bashkëpunim me kompaninë konsulent "INSI" Sh.P.K me seli në Prishtinë, konform Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013" dhe konform UA të MMPH-Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

5. Anëtarët e EKP-së obligohen që të ofrojnë përkrahjen e tyre profesionale dhe intelektuale nga fushë-veprimtaria e drejtorisë përkatëse. Në moment kur kërkohen informata dhe propozime profesionale nga lëmi që ofron drejtoria përkatëse, anëtari përfaqësues i drejtorisë mund të kërkojë nga zyrtarët kompetent brenda drejtorisë por edhe jashtë saj siç janë: intelektualë, ekspertët të pavarur, shoqata të ndryshme e të ngjashme (në këto raste duhet të mbahet evidenca e ofruesit të informatës respektivisht idesë dhe propozimi: në dosje).
6. EKP-ja obligohet të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, shoqatat, grupet e interesit, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend të Komunës e të ngjashme, në kuptim të gjithëpërfshirës dhe rritjes së cilësisë së planit.
7. Plani Zhvillimor Komunal duhet të përfundojë, me të gjitha procedurat, brenda vitit kalendarik 2018.
8. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa mandati i EKP përfundon me aprovim të PZHK-së nga Kuvendi të Komunës.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ



I dorëzohet:
DUP-së
Anëtarëve të ekipit,
Në dosje,